



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndertesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/955  
Date: 1 / 8 / 2022

## KONTRATË

Numri i kontratës <sup>1</sup>: 242-22-5047-1-1-1/C293

UNIVERSITETI I PRISHTINËS, (në vazhdim “Autoriteti Kontraktues”), në njëren anë; dhe N.T.P “ERAMED”, Vasil Andoni, PRISHTINË, (ne vazhdim “Furnizuesi”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike përfurnizimet e shënuara me poshtë:

“Furnizim me Paisje Laboratorike përf FSHMN” me numër identifikues: 242-22-5047-1-1-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Lot-2- "Furnizim me paisje dhe mjete Konkretizimi përf Departamentin e Fizikës"

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor përdorëzim do të jetë 90 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëziimit të furnizimit do të jetë FSHMN.

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetë LPP-së.

### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në ljalë.

### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 133,300,00 €; [Një tre tre Tre zero. zero .zero zero] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtronen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

## **Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>3</sup> në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Furnizuesin.

---

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Për Autoritetin Kontraktues Universiteti i Prishtinës**


**"Hasan Prishtina "**

Emri:	Mr.Sc.Perparim Shurdhiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.07.2022
Vula:	

**Për Autoritetin Kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina "**

Emri:	Ma.sc. Besfort Krasniqi	Emri:	Prof. dr. Naser Sahiti
Pozita:	Ud. Sekretar i Përgjithshëm në UP-së	Pozita:	Rektor i UP-së
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.07.2022	Data:	01.08.2022
Vula:		Vula:	

**Për Ofruesin e Furnizimeve N.T.P "ERAMED"- Prishtinë**

Emri:	FATIMIR ISAJI
Pozita:	DIREKTOR
Nënshkrimi:	
Data:	28.07.2022
Vula:	



# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 242-22-5047-1-1-1/C293

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazhme.

1.3 "Autoriti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombe të tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave të tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohej në formularin e kontratës, në përpunhje me shtesa të tillë dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrimet e njashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përsitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates. Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktoren.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tillë për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

## Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkua e licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendojë që të marrë lejet e kërkua apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

## Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçëtësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhë të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhë të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informata e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikoje ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

## Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim

nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

#### Neni 9              **Siguria e ekzekutimit**

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontrakte nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjesë të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkohshme të pranimit.

#### Neni 10              **Sigurimi**

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e tretë për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

#### Neni 11              **Programi i realizimit**

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbarë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilët Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyet e autoritetit kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilët programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatini e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njoftoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura ne kontratë programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qofte se nuk ka afai te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të janë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të janë në gjuhën e kontratës dhe në forma dhe numrat të tilla të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tillë janë furnizuar Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 12              **Marrëveshjet tatimore dhe doganore**

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuar në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 13              **Patentat dhe licencat**

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 14              **Periudha e ekzekutimit të detyrave**

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenit 2. pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies

së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përvèç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mblidhen në rastet kur një Furnizues i jepen më shumë se një sasi.

### Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjë tërë nga këto arsyë:

- Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përvèç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- Forca madhore;
- Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë. Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues. brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njofim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

### Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njofim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njofojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

### Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- prodhimin e furnizimeve;
- dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Ojatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonje vend tjetër, nga përkqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është

pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do t'ë marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- është i nevojshëm për arsyet e kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjesë të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do t'ë ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përvç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do t'ë përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do t'ë bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njofuar autoritetin kontraktues, mund t'ë kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose t'ë ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënes ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përbajtjesore, parregullsive ose mashtimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund t'ë refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcione me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që t'ë verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund t'ë konfirmohen, realizimi i kontratës do t'ë rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do t'ë janë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund t'ë shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe t'ë janë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet t'ë mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet t'ë bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do t'ë saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe t'ë tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do t'ë bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkesë duhet t'ë certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se t'ë inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do t'ë inkorporohen në furnizime ose në prodhim t'ë komponentëve që do t'ë furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund t'ë refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet t'ë ndërohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do t'ë pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që t'ë jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

## Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do t'ë sigurojë që furnizimet t'ë dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që t'ë paraqesë ndonjë arsyet përvonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do t'ë ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe t'ë kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që t'ë përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do t'ë bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Përqëllime të testimeve dhe inspektimeve të tillë, Furnizues do t'ë:

- I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- T'ë merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do t'ë realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që:

përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuara si duhet të rezultateve të testit te Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia jepë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrëthana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimt do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimt.

## Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V. Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. i njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do t'ë jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i jasin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

## Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të janë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, eksposimin në temperaturë ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënim i dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të janë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palë se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

## Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të janë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me konratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshterinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me konratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me konratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e konratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrove. Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj. Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'u paguar Furnizuesit.

